



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. **58**

Prishtinë, më 1.12.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Haset Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi, Elheme Hetemi, Dragiša Mirić, Myrvete Pantina.

Munguan : Zef Morina, Zulfi Merxha, Ali Lajçi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : ministri Yagcillar dhe këshilltari i ministrit Vehapi, vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Takimi me këshilltarin e ministrit Vehapi dhe me ministrin Yagcillar,
3. Të ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Naser Rugova-kryetar** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**2. Takimi me ministrin Vehapi (këshilltarin) dhe Yagcillar**

Fillimisht **Berat Luzha** bëri vërejtje për mospraninë e ministrit Vehapi, sidomos kur është në pyetje çështja e rëndësishme rreth pyjeve.

**Kryetari Naser Rugova** falënderoj për pjesëmarrje të ministrit Yagcillar ndërsa për mospraninë e ministrit Vehapi propozoi lëshim kolegjal për të vazhduar mbledhja, për shkak të çështjes urgjente të pyjeve. Ai shkurtimisht elaboroi për kërkesën e këtij komisioni që konsiston në arritjen e koordinimit për një draft të përbashkët dhe të akceptueshëm të dy ministrive për nenin 7.1 të Ligjit për Pyje, së pari ja dha fjalën ministrit **Yagcillar** i cili tha se MMPH dhe MBPZHR gjatë mandateve të kaluara nuk kanë arrit marrëveshje për çështje

pyjore përkatësisht për menaxhimin e tyre, ndaj propozoi që marrëveshja të bëhet tani duke propozuar nga një anëtarë nga tre trupat e pranishëm (MMPH, MBPZHR dhe Komisioni). Pasi që ministri ceku se ka marrëveshje të jozbatueshme në mes dy ministrive, **Elheme Hetemi** pyeti cilat janë ato, ai ofroi kryetarit draftin e Ohrit (7 nëntor 2008) në mes MMPH dhe MBPZHR ku përcaktohen përgjegjësitë për menaxhimin me parkun nacional :

- politikat e MMPH do të jenë udhëheqëse,
- MMPH siguron fondin për funksionim normal të administratës së parkut,
- MMPH do të jetë udhëheqëse e procesit të hartimit të planit menaxhues dhe hapësinor (Kuvendi) implementimi i së cilës do të bëhet përmes Drejtorisë së Parkut Nacional-DPN,
- Aktivitetet pyjore në pajtim me planin menaxhues do të kryhen nga APK nën monitorimin e autoritetit të parkut,
- Biodiversiteti (mirëmbajtja) do ti takoi MMPH,
- Eko-turizmi nën monitorimin e DPN (MMPH) si dhe komunikimi me banorët lokal dhe vizitorët bashkë me kontrollin e përditshëm të prerjeve.

Ministri më tutje vazhdoi duke konstatuar se kjo marrëveshje nuk është zbatuar dhe Kosova momentalisht ka vetëm një park nacional nga 1986, më tutje synohet që MMPH ti administroi ato pas miratimit të ligjit për mbrojtjen e natyrës ku do të përfshihen edhe parqet tjera për të cilat nuk ka pasur konsensus deri tani. Sa i përket marrëveshjes së cituar ai tha se marrëveshje gojore parimore ekziston por ajo duhet të shndërrohet në gjuhën ligjore të shkruar. **Elheme Hetemi** sugjeroi të shikohen përvojat nga rajoni që me siguri do të ishin në ndihmë. Ministri tha se ato janë të ndryshme, në disa shtete parqet menaxhohen nga kabineti i kryeministrit, në disa shtete ministria e mjedisit (aty ku ka stabilitet në këtë aspekt), në disa tjera është ndryshe etj.

**Njazi Idrizi (këshilltar i ministrit Vehapi)** propozoi që sugjerimet e ministrit Yagcillar të shtyhen për vitin e ardhshëm për shkak se janë në hartim e sipër planet për menaxhimin e pyjeve 2010-2020.

**Naser Rugova** nuk kundërshtoi por tha se komisioni duhet të marr qëndrim për propozimin e MMPH.

**Berat Luzha** nuk përkrahu propozimin e ministrit Yagcillar për formimin e grupit por tha se komisioni duhet të vendos vet.

**Naim Maloku** tha se analizat rreth projektligjit në fjalë janë të tejzgjatura dhe të shterura duke falënderuar Berat Luzhën rreth angazhimit për këtë projektligj, ndaj propozoi që komisioni të përfundoi shqyrtimin e projektligjit me miratimin e amendamenteve të sugjeruara nga GP duke mos miratuar propozim amendamentin e MMPH e cila ka kërkuar që nga neni 7.1 të Ligjit për Pyje të fshihen fjalët “si dhe pyjeve në parqet nacionale në Kosovë”, pasi që me dy ligjet që do të hartohen (për pyje dhe për parqe) do të rregullohet kjo çështje e rëndësishme. Ai përfundoi diskutimin me konstatimin se ndaj mjedisit nuk kemi opozitë dhe nuk do të kemi edhe në të ardhmen.

**Selvie Halimi** tha se nuk është propozim i keq i ministrit Yagcillar, por sa garanton ajo për sukses brenda një jave kur nuk kemi një draft-marrëveshje në mes dy ministrive, ndaj ishte e mendimit se duhet të procedohet ky projektligj si zgjidhje më fatlume për këtë moment ngase ministria e bujqësisë është e obliguar të mbrojë edhe aspektin mjedisor të pyjeve, ndërsa sa i përket fjalisë që propozohet nga MMPH të fshihet, mund të mbetet për më vonë me rastin e hartimit të ligjeve të cekura më lartë ose të miratohet propozimi.

**Heset Cakolli** për shkak se nuk ka unitet në mes dy ministrive propozoi të mbetet në fuqi sugjerimi i Naim Malokut për të proceduar projektligjin me amendamente të miratuara.

**Myrvete Pantina** gjithashtu përkrahu diskutuesit e mëparshëm duke konstatuar se ligjet e reja që do të hartohen do të jenë bazë për rregullimin e çështjeve kontestuese.

**Muzafer Luma** konstatoi se çfarëdo implikimi tjetër do të sjellë telashe të reja, ndaj u pajtua me anëtarët e komisionit.

**Naser Rugova** tha se komisioni duhet të hartoi në këtë fundvit planet e veta ndaj ftoi ministrin Yagcillar të jap sqarime rreth raportit të progresit Evropian për pikat sa i përket këtij komisioni : 50, 77, 78,79, 80,81,82 dhe 85.

Ministri **Yagcillar** dhe **sekretari Shefki Zeqiri nga MBPZHR** u pajtuan që të raportojnë komisionin në baza tremujore rreth çështjeve që kërkohen nga BE, në pikat e cekura për Ligjin për Verëra, Bordi për Mbrojtje të Mjedisit etj.

**Kryetari** apeloj tek zyrtarët e dy ministrive që të jenë në përcjellje të çdo hapi të agjencisë Evropiane dhe të raportojnë rregullisht ngase komisioni parlamentar për integritet Evropiane përkatësisht Kuvendi duhet të raportoj poashtu në baza tremujore institucionet Evropiane për planin e veprimit. Ai në vazhdim falënderoi duke përcjell mysafirët dhe konstatoi përfundimin e komisionit si vijon :

## P Ë R F U N D I M

1. **Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pyje procedohet më tutje me amendamentet e miratuara në mbledhjen e fundit të komisionit.**
2. **Nuk miratohet propozimi i MMPH për fshirjen e fjalëve nga neni 7.1 të Ligjit për Pyje “si dhe pyjeve në parqet nacionale në Kosovë”.**

**Elheme Hetemi** i japi edhe ca sugjerime për ligjet që duhet të hartohen duke arritur marrëveshje dy ministrin me kusht që APK të mbetet menaxhues dhe planifikues i pyjeve. **Naser Rugova** theksoi se asgjë nuk do të mbetet anash, sepse seanca plenare është ajo e fundit që vendos dhe ku mund të bëhen sugjerime përfundimtare.

### 3. Të ndryshme

**Naser Rugova** vazhdoi me disa çështje tjera që do të jenë objekt shqyrtimi në takimin e nesërm me kryeparlamentarin, siç janë :

- **fondi i komisionit** për vitin 2010 nuk ka mundësi për shtesë pasi që nuk është shfrytëzuar gjatë këtij viti, për këtë fond shumë shpejt do të hartohet një propozim me shkrim për komisionin për vitin 2010 bashkë me përfaqësuesin e OSCE, fondi prej 10.000 eurosh është e vogël, mirëpo do të shfrytëzohet sa më racional dhe për funksion të suksesshëm të komisionit: dëgjime publike jashtë Kuvendit, ekspert ndërkombëtar ose vendor për komisionin i cili do të bashkëpunoi me stafin e komisionit etj.
- Kërkohet që **Zef Morina** të ftohet dhe të pyetet se a është në gjendje të realizoi obligimet që dalin nga përfundimet e komisionit, për projektligjin që është angazhuar etj.
- Sqarime për procedimin e projektligjit për **Organizmat e Modifikuara Gjenetiki**sh të kërkohet nga Sekretaria e Kuvendit (**Naim Maloku**),
- Projektligji për “Rrezatimet Jonizuese” është proceduar në procedim të rregullt tek komisioni për Buxhet dhe ende nuk ka vërejtje me shkrim që do të shërbente këtij komisioni për të vepruar më tutje,
- Këtij komisioni t’i mundësohet krijimi i kushteve normale për punë, zyre për komision dhe staf, staf mbështetës (këshilltarë ligjorë), të incizohen mbledhjet e komisionit dhe të arkivohen këto incizime (**Berat Luzha**),
- Të dominoj niveli i përgjegjësisë, fleksibiliteti dhe aktiviteti i komisionit në përgjithësi (kryetari në radhë të parë pastaj edhe anëtarëve të komisionit), të përmirësohen kushtet e punës ku ka hendikepe mjaft të mëdha pa pasur kushte për këshillime, të hartohet një plan menaxhues për fondin e komisionit (**Elheme Hetemi**),

- Deputeti të ketë më tepër hapësirë për veprim profesional dhe përfundimisht të ketë zyrën e vet (**Naser Rugova**).

**Komisioni** përkrahu këto kërkesa në mënyrë që sa më shpejt të funksionalizohen.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,10. Mbledhja e radhës do të mbahet më 8.12.2009 për projektligjin e ajrit dhe informatën nga Sekretaria për OMGJ, me mundësin e shkuarjes në një drekë të përbashkët të mbështetur nga OSCE.

Kryetari i Komisionit,  
**Naser Rugova**